

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Irani krijon portalin online për denoncimin e kritikëve që jetojnë jashtë vendit, rreth 600 të raportuar
ADRESA	https://piranjat.al/bota/iran-krijon-portalin-online-per-denoncimin-e-kritikeve-qe-jetojne-jashte-ve-i104221
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:04:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:54:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e6b8c748d5b2f7ba8915b14f03d1d9d0fcdb322291e8d8e7af6eb6dd8f171c0
TEKSTI	3f714111513cb363cef8c356fd2db808213b38c950c52d64fc799566b14929c9
PAMJA	37240a4b3c39b17360e73902bd1c4dd5fccde481c1aedd22cf02889a30cbbedd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4accbc9a55f4637646ce16023d611fafb8e4f311cff330bd391c5afa31d20c6d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4accbc9a55f4637646ce16023d611fafb8e4f311cff330bd391c5afa31d20c6d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: **shperbien** nënshkrimit të kontrarës së re me **Flash: trajnerin Luis de** ■ **4 i-vjeçari në** kishte kultivuar bimë narkotike n... ■ **Luizim Caka** ishinej me dy identitete, duke **udhëtonte** ■ **Ilir Metën** GJKKO ka rrezuar kërkesën e tij për **banda shqiptare në** në kuadër të një hetimi për një rrjet ndërkombëtar ■ **procedura** dy të

BOTA

Irani krijon portalin online për denoncimin e kritikëve që jetojnë jashtë vendit, rreth 600 të raportuar

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 14:54



Autoritetet iraniane kanë vënë në funksion një platformë të re online për raportimin e personave që jetojnë jashtë vendit dhe që konsiderohen nga regjimi si kundërshtarë ose "tradhtarë". Portali quhet "Alaj", që në shqip nënkupton "Shërim", dhe sipas autoriteteve iraniane është krijuar në kuadër të përpjekjeve për mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Media shtetërore e paraqet platformën si një mekanizëm për identifikimin e personave që, sipas Teheranit, veprojnë kundër interesave të Iranit.

Agjencia gjysmëzyrtare e lajmeve Fars ka paralajmëruar se personat që konsiderohen "tradhtarë" mund të përballen me pasoja ligjore. Përmes portalit dhe kanaleve të lidhura me të në rrjetet sociale, qytetarët mund të dërgojnë informacione dhe ankesa për iraniane që jetojnë jashtë vendit dhe që dyshohet se mbështesin qëndrime kundër regjimit.

Autoritetet pretendojnë se të dhënat e personave që bëjnë raportimet do të ruhen në mënyrë konfidenciale. Sipas raportimeve, platforma synon veçanërisht iranienët që shprehin publikisht mbështetje për sanksionet ndërkombëtare ndaj Teheranit ose për veprime ushtarake kundër Iranit. Tensionet e krijuara nga përplasja mes Iranit, SHBA-së dhe Izraelit kanë shtuar vigjilencën e autoriteteve iraniane ndaj kundërshtarëve të regjimit, përfshirë ata që jetojnë jashtë vendit.

Sipas të dhënave të publikuara në faqen e platformës, deri tani janë raportuar rreth 600 persona, ndërsa informacionet për disa iraniane që jetojnë jashtë vendit janë bërë publike në bazën e të dhënave të portalit. Rreth 4 milionë persona me origjinë ose shtetësi iraniane jetojnë jashtë Iranit.

Një pjesë e komunitetit iranien është larguar nga vendi për arsye politike, ndërsa aktiviteti i shërbimeve iraniane të inteligjencës jashtë territorit të vendit ka qenë prej kohësh një çështje shqetësuese për komunitetet e emigrantëve. Ende nuk është e qartë se sa do të zgjerohet përdorimi i platformës "Alaj" dhe se cilat masa konkrete do të ndërmerren ndaj personave të raportuar përmes saj.

Artikuj te sugjeruar

BOTA 15 Shtator14:53

[OKB kërkon hetime për Gazën! Ngrihen shqetësime për krime lufte pas gjetjes së mijëra trupave](#)

Shefi i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka ngritur shqetësime për respektimin e ligjit ndërkombëtar dhe mundësinë...

BOTA 15 Shtator14:51

[Pse Evropa është e shqetësuar nga fabrika e robotëve kinezë në Serbi?](#)

Në fund të korrikut, administrata Trump njoftoi një masë kontroverse që ndalonte modelet e reja të robotëve të avancua...

BOTA 15 Shtator14:41

[Sistemi EES sjell vonesa, nëntë vende të BE-së kërkojnë shtyrjen e kontrolleve të reja](#)

Nëntë vende të Bashkimit Evropian, mes tyre Franca, Greqia, Italia dhe Portugalia, kanë kërkuar më shumë kohë për...

BOTA 15 Shtator11:27

[Ushtria amerikane konfirmon se lufta me Iranin ka çuar në mungesë municionesh](#)

Në një raport të detyrueshëm të parë të këtij lloji për Kongresin, inspektori tha se midis 28 shkurtit dhe 30 qer...

BOTA 15 Shtator10:48

[Vuçiç vendos të kandidojë për kryeministër në tetor](#)

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, pas qeverisjes së tij 12-vjeçare, tha se do të kandidojë për postin e kr...

BOTA 15 Shtator10:27

[Tension në ujërat ndërkombëtare, fregata ruse lëshon dy raketa drejt një helikopteri danez](#)

Në një tjetër incident që ka rritur tensionet, Danimarka ka denoncuar veprimet e një fregate ruse, e cila dyshohet se ka lëshuar...

BOTA 15 Shtator09:41

[Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane ngre alarmin: Evropa rrezikon të mbetet peng i SHBA-së dhe Kinës për inteligjencën artificiale](#)

Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane, Christine Lagarde, ka paralajmëruar se Evropa duhet të zhvillojë modelet e veta të inteligje...

Nga Ron Bousso BOTA 15 Shtator09:30

[Armëpushimi energjetik i Trumpit në Ukrainë nuk do ta zgjidhë krizën globale të naftës](#)

Një armëpushim në infrastrukturën energjetike që Presidenti i SHBA-së Donald Trump arriti midis Rusisë dhe Ukrain...

BOTA 15 Shtator09:23

[Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa dhe dronë](#)

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

BOTA 15 Shtator09:07

[Rusia godet stacionin e benzinës dhe depot në kryeqytetin e Ukrainës](#)

Një dron goditi një pikë karburanti në Kiev gjatë orëve të para të mëngjesit, njoftoi kryebashkiaku i kryeqytetit...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

[FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...](#)

Një shtetas shqiptar është dënua me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

BOTA 14 Shtator

[“E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite”/ Bash...](#)

Një burrë britanik pranoi sot se kishte drogua dhe përdhunua gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...


INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gazetari në Bishanjo: Kam 20 vite që më duan të rrodhja ndaj mek dal Unazë në publik](#)

[Syri TV për 10 vitet e fundit të jetës së tij me qendrën e vrasjeve dhe krimin në peshirë](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.